





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 3851, Datë 08/05/2009

PËR  
MIRATIMIN E “KODIT TË ETIKËS TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË  
SHTETËRORË DHE PRIVATË”.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 10, shkronja “c” të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, nenit 10, pika 2 të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor”, nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

- I. Miratimin e “Kodit të Etikës të Përbaruesve Gjyqësorë Shtetëror dhe Privat”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.
- II. Revokimin e Urdhrit nr. 200, datë 17.01.2005 “Për miratimin e Kodit Etik të Përbaruesve Gjyqësor”.
- III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit dhe struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e veprimtarisë së përbaruesve gjyqësorë privat për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ENKELEJD ALIBEAJ



